

T O L K I T


SAFER
GRASSROOTS
SPORT


Co-funded by
the European Union

Sporti ka fuqinë të frymëzojë, të bashkojë komunitetet dhe të formësojë vlera që zgjasin një jetë të tërë. Megjithatë, që sporti të realizojë vërtet potencialin e tij, ai duhet të jetë i sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë – veçanërisht në nivelin bazë, aty ku fillojnë shumë udhëtime.

Projekti GRASS – Sporti i Sigurt në Nivelin BAZË ka lindur nga kjo besim. Si organizata koordinuese e këtij projekti, Komiteti Olimpik Kombëtar i Portugalisë është krenar që udhëheq një partneritet institucionesh të përkushtuara nga e gjithë Evropa, të bashkuara **nga angazhimi i përbashkët për të mbrojtur sportin nga çdo formë dhune dhe abuzimi.**

Së bashku, synojmë të ndërtojmë kapacitete për organizatat sportive në nivelin bazë **që të krijojnë mjedise më të sigurta, dhe Mjetet Digjitale të Sportit të Sigurt**, së bashku me **mjetin e vetëvlerësimit**, janë një nga rezultatet kryesore të projektit GRASS.

Mjetet Digjitale të Sportit të Sigurt përbëhen nga **një grup burimesh praktike të dizenuara për të mbështetur klubet në zbatimin e politikave për mbrojtjen** dhe për të përmbushur detyrimin e tyre për kujdes ndaj sportistëve, trajnerëve, vullnetarëve dhe të gjithë anëtarëve të komunitetit sportiv.

Në varësi të kapaciteteve dhe nivelit të angazhimit të klubit tuaj, **mund të zbatoni veprime bazë, të ndërmerrni hapa të mëtejshëm, ose të zbatoni një qasje më gjithëpërfshirëse.**

“Shpresa jonë është **që ky mjet të fuqizojë çdo klub sportiv** në nivelin bazë që të ndërmarrë hapa konkretë drejt një mjedisi më të sigurt në sport.”

Në emër të KOK të Portugalisë, falënderoj të gjithë partnerët e përfshirë në këtë projekt për kontributet e tyre të paçmueshme dhe mezi pres të vazhdojmë së bashku këtë punë të rëndësishme.

Le të sigurohemi që sporti në nivelin bazë të mbetet një hapësirë për rritje, përfshirje dhe siguri – për të gjithë.

Fernando Gomes
President
Komiteti Olimpik Kombëtar i Portugalisë



*Shpresa jonë është që ky
mjet të fuqizojë çdo klub
sportiv në nivelin bazë
që të ndërmarrë hapa
koncretë drejt një
mjedisi më të
sigurt në sport.*

*Mjeti përbëhet nga
9 fusha (rrjedha pune)
dhe për secilën fushë
ka një numër burimesh
mbështetëse.*

Këshilla dhe teknika për zbatimin e veprimeve	4
Mjeti Digjital i Sportit të Sigurt	5
Hapi 1	8
Korniza politike për mbrojtjen në sport	
Hapi 2	12
Sistemi dhe struktura për reagimin ndaj shqetësimeve	
Hapi 3	17
Këshilla, mbështetje dhe informacion	
Hapi 4	21
Korniza për edukim dhe trajnime	
Hapi 5	25
Standardet minimale të funksionimit	
Hapi 6	30
Sjellja, udhëzimet dhe etika	
Hapi 7	34
Rekrutimi i sigurt i stafit dhe vullnetarëve	
Hapi 8	38
Partneritetet dhe burimet	
Hapi 9	41
Monitorimi, vlerësimi dhe të nxëniet	
Termet dhe përkufizimet kryesore	44

*Filloni me këto këshilla
dhe teknika dhe
ndërmerrni hapa të
mëdhenj përpara në punën
për mbrojtjen në klubin
tuaj sportiv.*

✱ A është klubi juaj sportiv i **ANËTARËSUAR NË NDONJË SHOQATË OMBRELL SPORTIVE** ose federatë sportive kombëtare? Kërkojuni ndihmë për zbatimin e këtyre fushave të ndryshme.

✱ Nuk jeni vetëm! **LEJONI EDHE TË TJERËT TË MENDOJNË PËR POLITIKËN E MBROJTJES NË KLUBIN TUAJ.** Fëmijët, prindërit, anëtarët e bordit dhe trajnerët kanë të gjithë një opinion për mënyrën se si duan të kontribuojnë në një mjedis sportiv të sigurt. Përfshini personat e interesuar për të punuar së bashku në realizimin e veprimeve.

✱ **ORGANIZONI NJË SEANCË VJETORE INFORMUESE** për të gjithë klubin, në të cilën shpjegoni politikën tuaj të mbrojtjes dhe prezantoni Oficerin për Mbrojtje dhe rolin e tij/saj.

✱ Mos humbisni mundësinë për të **KËRKUAR MENDIMIN E ANËTARËVE TUAJ** për masat që keni ndërmarrë lidhur me kuadrin tuaj të politikës për sportin e sigurt. Duke kërkuar komente dhe duke i marrë ato parasysht, po hidhni sërish disa hapa përpara!

✱ Dhe së fundi, Krijimi i një kuadri të politikës për sportin e sigurt nuk është diçka që mund të bëhet brenda një dite. **BËJENI HAP PAS HAPI.** Me ndihmën e këtij mjeti, mund të krijoni një plan të fortë dhe ta zbatoni veprimi pas veprimi, me ritmin tuaj dhe sipas nevojave të klubit tuaj.

Ju urojme fat!

të mirë dhe faleminderit që i përkushtoheni një bote sportive të sigurtë për të gjithë!

MJETET DIXHITALE PËR SPORTIN E SIGURT

Mjet Dixhital i mjeteve përbëhet nga 9 fusha (rrjedha pune) dhe për secilën prej tyre ka një numër **burimesh mbështetëse**. Në varësi të kapacitetit dhe angazhimit brenda klubit tuaj, mund të ndërmerrni

veprime themelore, të bëni pak më shumë ose të zhvilloni një qasje gjithëpërfshirëse.

Mund të shkarkoni burimet e veçanta për secilën fushë në çdo rrjedhë pune individuale, më poshtë në këtë komplet mjetes.

Nëse e keni përfunduar më parë **Mjetin e Vetëvlerësimit për Sport të**

Sigurt, keni marrë një tregues të nivelit në të cilin mund të filloni çdo rrjedhë pune. Ky është vetëm një tregues, gjithmonë kontrolloni veprimet në nivelet e mëparshme, mund t'ju duhet të filloni me një numër veprimesh të mëparshme më parë.

Ju urojmë fat!

HAPI

1

Korniza politike për mbrojtjen në sport

FILLESTAR

VEPRIMI 1 ✳ përcaktoni vizionin e klubit tuaj për mbrojtjen dhe përfshini mbrojtjen në statutin e klubit
VEPRIMI 2 ✳ përkrahni llojet kryesore të dhunës ndërpersonale

I MODERUAR

VEPRIMI 3 ✳ konsultohuni me njerëzit, veçanërisht me fëmijët, gjatë hartimit të politikës

I PËRPARUAR

VEPRIMI 4 ✳ krijoni një politikë mbrojtjeje të përshtatur për klubin tuaj sportiv

2

Sistemi dhe struktura për reagimin ndaj shqetësimeve

VEPRIMI 1 ✳ emëroni Oficerin për Mbrojtje të klubit dhe komunikoni ekzistencën e tij/saj në klub
VEPRIMI 2 ✳ krijoni mekanizmat e raportimit të klubit tuaj
VEPRIMI 3 ✳ krijoni procedurën e raportimit të klubit tuaj

VEPRIMI 4 ✳ krijoni procedurën e reagimit të klubit (protokoll ndjekjeje si udhëzues për menaxhimin e rasteve në klub)

VEPRIMI 5 ✳ monitoroni dhe ruani në mënyrë të sigurt informacionin e raportuar/mbledhur

HAPI	FILLESTAR	I MODERUAR	I PËRPARUAR
3 Këshilla, mbështetje dhe informacion		VEPRIMI 1 🦋 ofroni informacion dhe mbështetje gjatë dhe pas një incidenti ose ankese	VEPRIMI 2 🦋 bëni që Oficeri për Mbrojtje të bashkëpunojë me Oficerë të tjerë për Mbrojtje
4 Korniza për edukim dhe trajnim	VEPRIMI 1 🦋 trajnoni Oficerin për Mbrojtje VEPRIMI 2 🦋 ngrini ndërgjegjësimin për mbrojtjen në klub.		VEPRIMI 3 🦋 përfshini temën e mbrojtjes në procesin e orientimit për stafin e ri
5 Standardet minimale të funksionimit	VEPRIMI 1 🦋 përcaktoni procedurat e mbrojtjes për ambientet e ndërrimit të rrobave VEPRIMI 2 🦋 përcaktoni procedurat e mbrojtjes për transportin e pjesëmarrësve sportivë VEPRIMI 3 🦋 përcaktoni procedurat e mbrojtjes për udhëtimet ditore dhe ato me qëndrim VEPRIMI 4 🦋 përcaktoni procedurat e mbrojtjes për raportin staf-pjesëmarrës dhe mbikëqyrjen VEPRIMI 5 🦋 përcaktoni procedurat e mbrojtjes për fotografimin, filmimet, sigurinë online, rrjetet sociale dhe bullizmin/bullizmin kibernetik.	VEPRIMI 6 🦋 komunikoni ekzistencën e të gjitha këtyre procedurave të mbrojtjes në klub	VEPRIMI 7 🦋 përcaktoni procedurat e mbrojtjes për vlerësimin dhe reduktimin e riskut
6 Sjellja, udhëzimet dhe etika	VEPRIMI 1 🦋 krijoni kode sjelljeje për të gjitha grupet në klubin tuaj sportiv	VEPRIMI 2 🦋 shpërndani dhe promovoni kodet e sjelljes	VEPRIMI 3 🦋 sigurohuni që stafi t'i nënshkruajë dhe t'i përmbahet kodeve të sjelljes

HAPI	FILLESTAR	I MODERUAR	I PEPARUAR
7 Rekrutimi i sigurt i stafit dhe vullnetarëve	VEPRIMI 1 ✨ përcaktoni profilin e punës dhe procedurat e rekrutimit	VEPRIMI 2 ✨ përfshini kontrollet e historikun ne pune ne metodën tuaj të rekrutimit	VEPRIMI 3 ✨ kontrolloni dëshminë e penalitetit.
8 Partneritetet dhe burimet		VEPRIMI 1 ✨ krijoni marrëveshjepartneriteti për të mbështetur klubin në çështjet e mbrojtjes	VEPRIMI 2 ✨ merrni parasysh parimet e mbrojtjes kur krijoni marrëveshje partneriteti
9 Monitorim, vlerësim dhe të mësim			VEPRIMI 1 ✨ monitoroni dhe vlerësoni politikat dhe procedurat e mbrojtjes në klub

H A P I 1

Korniza e politikave për *mbrojtjen* në sport



Puna për mbrojtjen në klubin sportiv fillon me zhvillimin e një kuadri dhe vizioni të qartë. Ky vizion udhëzon vendimet dhe siguron që të gjithë në klub të shikojnë në të njëjtin drejtim. Ne e përfshijmë këtë vizion në statutin e klubit dhe ua bëjmë të ditur të gjithë atyre që janë aktivë në klub. Kur zhvillojmë një politikë për mbrojtjen, ne përfshijmë sa më shumë njerëz aktivë në klub, kryesisht fëmijët. Në këtë mënyrë, një mjedis i sigurt sportiv është i dukshëm për të gjithë.



Krijoni një kuadër të fortë politikash për të mbrojtur të gjithë të përfshirë në sport.

FILLESTAR



VEPRIMI 1

përcaktoni vizionin e klubit tuaj për mbrojtjen dhe përfshini mbrojtjen në statutin e klubit
Në këtë mënyrë, rëndësia që klubi i kushton temës së mbrojtjes ngulitet në dokumentet ligjore të klubit tuaj sportiv.



VEPRIMI 2

Përshkruani llojet kryesore të dhunës ndërpersonale

Për të vendosur mbrojtjen në agjendën e klubit sportiv, është e rëndësishme që të gjithë të kenë një kuptim të mirë për atë që nënkupton kjo temë. Njohuria për çështjen është thelbësore për të punuar së bashku.

Përfshini këto përkufizime të llojeve të ndryshme të dhunës ndërpersonale në klubin tuaj sportiv.

I MODERUAR



VEPRIMI 3

Konsultohuni me njerëzit, veçanërisht me fëmijët, gjatë hartimit të politikës
Përdorni këto udhëzime për të formuar politikën mbi mbrojtjen në mënyrë pjesëmarrëse brenda klubit tuaj sportiv.



VEPRIMI 4

Krijoni një politikë mbrojtjeje të përshtatur për klubin tuaj sportiv

Ky mjet ju ndihmon të krijoni një politikë për mbrojtjen në 9 fusha. Përcaktoni dhe prezantoni politikën hap pas hapi.



I PËRPARUAR



PRAKTIKË E MIRË

Vizioni i klubit për mbrojtjen

*Nga faqja e internetit e
Kempisch Triathlon Team*

**JO DHUNËS DHE
ABUZIMIT!**

Çdokush në sport duhet të ndihet i sigurt. Prandaj është e rëndësishme të parandalohet çdo formë e sjelljes së padëshiruar, si dhuna dhe abuzimi seksual, fyerjet, ngacmimi, diskriminimi, kërcënimet dhe sulmet fizike. Për më tepër, duhet të jetë e qartë se si të veprohet kur ndodh një incident.

Kur përballeni me dhunë dhe abuzim, kjo tregon se mjedisi (sportiv) nuk është më i sigurt. Kjo mund të ngjallë shumë emocione dhe pyetje, edhe nëse nuk jeni viktimë vetë, por thjesht dëshmitar. Mos e mbani për vete!

Sinjalizoni dhe flisni me dikë që i besoni. Të sinjalizoni menjëherë dhe të nxirrni në pah dhunën dhe abuzimin mund të parandalojë përsëritjen ose përkeqësimin e situatës.

H A P I 2

Sistemi dhe struktura për
reagimin ndaj shqetësimeve



Për të mundësuar raportimin e dhunës ndërpersonale, është e rëndësishme të caktohet dikush që mund të pranojë këto raportime: **Oficeri për Mbrojtje**. Ky person ka kompetencat e duhura për të dëgjuar, për të vlerësuar seriozitetin dhe për të ditur hapat që duhet të ndërmerren.

Klubi ka nevojë për një procedurë të qartë të raportimit. Qartësia mbi mënyrën e raportimit dhe informacioni mbi procesin që vijon më pas është thelbësor për të bërë raportimin sa më të arritshëm.

Sigurohuni që klubi juaj ka një protokoll transparent hap pas hapi për trajtimin e rasteve të dhunës ndërpersonale.

Duhet gjithashtu të mendoni se si do të ruani në mënyrë të sigurt këto raportime dhe kush do të ketë qasje në këtë informacion të ndjeshëm.

Krijoni sisteme dhe struktura që e bëjnë të lehtë raportimin e dyshimeve apo rasteve të dhunës ndërpersonale.

FILLESTAR



VEPRIMI 1

Caktoni Oficerin për Mbrojtje të klubit dhe komunikoni ekzistencën e tij/saj në klub

Gjatë këtij hapi ju përcaktoni rolin e Oficerit për Mbrojtje dhe profilin që kërkon për ta mbushur këtë rol.

Njerëzit brenda klubit sportiv nuk mund të raportojnë dyshime për dhunë ndërpersonale nëse nuk e njohin Oficerin për Mbrojtje. Sigurohuni që të gjithë e njohin Oficerin dhe dinë si ta kontaktojnë atë



I MODERUAR



VEPRIMI 4

Krijoni procedurën e reagimit të klubit tuaj (protokolli i ndjekjes si udhëzues për menaxhimin e rasteve në klub)

Protokolli hap pas hapi është udhëzuesi për menaxhimin e rasteve të dhunës ndërpersonale. Faza të ndryshme në këtë protokoll janë shtylla kurrizore e politikës së raportimit në klubin sportiv.



I PERPARUAR

VEPRIMI 5

Monitoroni dhe ruani në mënyrë të sigurt informacionin e raportuar/mbledhur

Kush ka akses për të lexuar raportet e shkruara? Kush informohet për raportimin brenda klubit? Si ruhen këto raportime në mënyrë të sigurt? Këtu do të gjeni disa këshilla për një politikë të sigurt kontrolli dhe ruajtjeje të raportimeve.





VEPRIMI 2

Krijoni mekanizmat e raportimit në klubin tuaj

A mund të bëhet raportimi me telefon? Apo përmes një formulari online? A është Oficeri për Mbrojtje i pranishëm gjatë stërvitjeve dhe/ose garave? Siguroni qartësi mbi “si”, “çfarë” dhe “ku” për ata që duan të raportojnë

VEPRIMI 3



Krijoni procedurën e raportimit në klubin tuaj

Bëni të qartë për të gjithë në klub se si funksionon një procedurë raportimi dhe shpjegoni çdo hap të saj. Në këtë mënyrë, ju ofroni informacion kyç për ata që mendojnë të raportojnë, në mënyrë që të ndihen të sigurt dhe të mbështetur.


PRAKTIKË E MIRË

Në faqen e internetit të Klubit BMX të Ostendit

Geertrui De Leersnijder u emërua nga bordi si Oficerja e re e Mbrojtjes përmes një mandati të qartë. Ne do t'ia lëmë Geertruit të prezantohet vetë me ju.

A po përballeni me dhunë, ngacmim, diskriminim, shantazh, frikësim, komente apo prekje të papërshtatshme seksuale? Po vëreni gjëra gjatë sportit që nuk i gjeni të pranueshme?

Keni shqetësime të tjera apo thjesht një ide shumë të mirë, por hezitoni të flisni me dikë?




Unë jam Geertrui De Leersnijder, Oficerja për Mbrojtje në klubin Ostend BMX Club. Mund të më kontaktoni në çdo kohë si sportist, prind, trajner, anëtar i bordit apo vullnetar i klubit tonë.

Mos hezitoni të më shkruani në email:

geertrui.deleersnijder@gmail.com ose të më

telefononi në: 0474/262541 ose të flisni me mua gjatë stërvitjeve apo garave.

H A P I 3



Këshilla, mbështetje
dhe informacion



Çdo klub sportiv ka një detyrë
thelbësore për të informuar

personat e duhur gjatë dhe pas
një incidenti apo ankese. Po aq e
rëndësishme është të forcohet roli
i Oficerit për Mbrojtje në mënyrë të
vazhdueshme. Kontakti i rregullt me
Oficerë të tjerë për Mbrojtje është
një hap kyç në zhvillimin e tyre.



Vazhdoni ta mbështesni Oficerin për Mbrojtje edhe pas përfundimit të trajnimit të tij/saj të parë.

I MODERUAR



VEPRIMI 1

Jepni informacion dhe mbështetje gjatë dhe pas një incidenti apo ankese

Mbani të informuar personat e përfshirë për ecurinë e trajtimit të një raportimi. Në këtë mënyrë ndërtoni besim, siguroheni që ata të mbeten të lidhur me klubin dhe u jepni ndjesinë se raportimi i tyre po merret seriozisht.



I PERPARUAR



VEPRIMI 2

Bëni që Oficeri për Mbrojtje të bashkëpunojë me oficerë të tjerë të mbrojtjes

Trajnimi fillestar është vetëm hapi i parë. Forcimi i vazhdueshëm i Oficerit në rolin e tij është thelbësor për zhvillimin profesional. Këshillimi dhe bashkëpunimi me kolegët është shumë mbështetës në këtë drejtim.



PRAKTIKË E MIRË


Nga faqja e internetit e Federatës së Xhudos së Flandrës (Belgjikë)

Moment intervizimi për Oficerët për Mbrojtje

8 shkurt 2024, ora 19:00 – 22:00

- ✓ A e konsideron klubi juaj të rëndësishme një mjedis të sigurt?
- ✓ A keni emëruar tashmë një Oficer për Mbrojtje dhe keni pyetje për disa incidente?
- ✓ Po mendoni të emëroni një në të ardhmen por keni ende paqartësi?

Regjistrohuni për këtë moment interaktiv për Oficerët për Mbrojtje!



Korniza për edukim
dhe trajnime



Të gjithë në klub duhet të jenë të vetëdijshëm për kushtet që sigurojnë një mjedis të sigurt sportiv.

Me anë të seancave informuese, klubi mund t'i ndërgjegjësojë anëtarët për rëndësinë e një mjedisi të këndshëm dhe përfshirës. Po ashtu, ata mund të mësojnë se çfarë është dhuna ndërpersonale dhe si mund të identifikojnë sinjalet tek viktimat e mundshme.

Anëtarët mund të informohen se si mund të reagojnë në situata të tilla dhe me kë mund të kontaktojnë.

Është shumë e rëndësishme të ketë një program të mirëtrajtimit për Oficerin për Mbrojtje dhe ta përfshijë mbrojtjen në procesin e orientimit për çdo anëtar të ri të stafit.



Vazhdoni të informoni anëtarët tuaj rreth sportit të sigurt në mënyrë që të gjithë të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e një mjedisi ku të gjithë mund të marrin pjesë në mënyrë të sigurt.

FILLESTAR



VEPRIMI 1

Trajnani Oficerin për Mbrojtje

Roli i Oficerit është shumë specifik dhe i ndjeshëm. Për të vepruar me kompetencë, një program edukimi i strukturuar është i domosdoshëm.

VEPRIMI 2



Risni ndërgjegjësimin për mbrojtjen në klub

Informoni anëtarët e klubit (online ose gjatë takimeve) për rëndësinë e një mjedisi sportiv të sigurt dhe si mund të reagojnë kur përballen me dhunë ndërpersonale.

I PEPARUAR

VEPRIMI 3

Përfshini mbrojtjen në orientimin e stafit të ri

Çdo person që fillon në klub si staf apo vullnetar prezantohet me politikat e mbrojtjes dhe detyrimet që burojnë prej tyre.



PRAKTIKË E MIRË

Nga Federata e Futbollit të Flandrës (Belgjikë):

*Trajnimi për Oficerin për Mbrojtje
përbëhet nga 2 punëtori:*

1. Si të trajtojmë dhunën ndërpersonale


Shembuj konkretë nga futboli mbi sjellje të përshtatshme dhe të papërshtatshme, si të reagojmë në raste dhune seksuale, fizike apo psikologjike.

2. Detyrat e Oficerit për Mbrojtje

Çfarë protokollesh mund të ndiqen si klub? Si të zhvilloni një politikë proaktive për mbrojtje brenda klubit?



Standardet minimale të funksionimit



Një politikë për mbrojtje krijon një kuadër të qartë për të gjithë që janë të përfshirë në klubin sportiv. Por si ta zbatojmë këtë në praktikë? Si mund të mbrojmë të rinjtë në dhomat e zhveshjes së klubit, gjatë transportit, apo gjatë qëndrimeve me fjetje nën mbikëqyrjen e një përfaqësuesi të klubit përveç prindërve të tyre?

? Cila është politika e klubit për sigurinë online, rrjetet sociale dhe fotografimin në kontekst sportiv?

Udhëzimet specifike në lidhje me rrethanat e ndryshme në të cilat gjenden pjesëmarrësit e rinj brenda klubit sportiv sigurojnë që të gjithë të dinë se çfarë pritet prej tyre.



Vëreni në praktikë politikën tuaj të sportit të sigurt! Krijoni udhëzime të përshtatshme për t'ua bërë të qartë të gjithëve në klubin tuaj sportiv se si mund të punoni së bashku për të krijuar një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt.

FILLESTAR



VEPRIMI 1

Përcaktoni procedura të mbrojtjes për dhomat e zhveshjes

Për shembull: deri në çfarë moshe mund të jenë prindërit apo trajnerët në dhomën e zhveshjes? Çfarë roli kanë ata?

VEPRIMI 2

Përcaktoni procedura për transportin e sportistëve

A është e pranueshme që trajneri të marrë pjesëmarrësin në makinë? Si komunikohet me prindërit për këtë?



I MODERUAR

VEPRIMI 6



Komunikoni ekzistencën e këtyre udhëzimeve në klub

Bëni të ditur për të gjithë rregullat dhe politikat për të shmangur paqartësitë

VEPRIMI 7

Përcaktoni procedura për vlerësimin dhe reduktimin e rrezikut

Sporti mund të përfshijë rrethana me rrezik më të lartë për dhunë ndërpersonale. Identifikoni këto rreziqe dhe merrni masa për t'i zvogëluar





VEPRIMI 3

Përcaktoni procedura për udhëtime ditore apo me qëndrime

Shumë të rinj marrin pjesë me entuziazëm në aktivitete sportive me qëndrime brenda apo jashtë vendit. Si garantoni sigurinë në këto rrethana?



VEPRIMI 4

Përcaktoni raportet e mbikëqyrjes dhe numrin e stafit


Sa persona të rritur për grup janë të nevojshëm? A ka gjithmonë më shumë se një trajner prezent?

VEPRIMI 5

Përcaktoni procedura për fotografimin, filmimet, rrjetet sociale dhe ngacmimet (përfshirë ngacmimet siguri kibernetike)

Sfidat online nuk janë pakësuar vitet e fundit. Shumë pjesëmarrës të rinj përballen me dhunë ndërpersonale edhe kur nuk janë në fushën sportive. Udhëzime të qarta janë gjithashtu të nevojshme këtu, në mënyrë që të gjithë të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur.





PRAKTIKË E MIRË

Fotografimi nga prindërit dhe spektatorët gjatë ngjarjeve

Minimizimi i rreziqeve

Vendosni një politikë për fotografimin nga spektatorët që në fazat e planifikimit të ngjarjes:

- ✓ ndalim i plotë i çdo lloj fotografimi
- ✓ regjistrim i personave që synojnë të bëjnë foto
- ✓ lejimi i fotografisë publike pa ndalim të përgjithshëm për ngjarjen
- ✓ vendi i zhvillimit të aktivitetit është hapësirë publike, prandaj ndalimi nuk është i mundur

Sqaroni dhe promovoni rregullat për fotografimin për të gjithë: stafin, vullnetarët, spektatorët, prindërit dhe pjesëmarrësit e rinj.

Në këto rregulla përfshini zonat ku fotografimi është i ndaluar, si për shembull dhomat e zhveshjes – për më shumë, klikoni tek seksioni “Telefonat celularë dhe kamerat në dhomat e zhveshjes”.

Paralajmëroni prindërit dhe spektatorët se mund të ketë pasoja negative nga ndarja e imazheve të lidhura me informacione rreth fëmijëve të tyre ose të të tjerëve në mediat sociale (Facebook, Twitter) – dhe duhet të tregohet kujdes në lidhje me “etiketimin”.

Vendosni procedura për t’iu përgjigjur dhe për të menaxhuar çdo shqetësim që lind, duke përfshirë struktura të qarta raportimi dhe një sistem për të kontaktuar policinë kur është e nevojshme.

H A P I 6



Sjellja, udhëzimet dhe etika



Si mund të dish se çfarë pritet nga ti kur merr një rol në një klub sportiv?

Këtu hyjnë në fuqi kodet e sjelljes. Një kod sjelljeje përcakton për secilën kategori në klub (sportistët, trajnerët, stafin mjekësor, prindërit, anëtarët e bordit, etj.) se çfarë sjelljeje pritet prej tyre.

Këto kode sjelljeje funksionojnë vetëm nëse njihen nga të gjithë diskutohen rregullisht janë të nënshkruara nga pjesëmarrësit. Duke nënshkruar kodin e sjelljes, pjesëmarrësit angazhohen që do t'i respektojnë rregullat në çdo kohë dhe do të kontribuojnë për një mjedis të sigurt dhe pozitiv në klub.



Krijoni kode sjelljeje për të gjitha grupet brenda klubit tuaj sportiv në mënyrë që të gjithëve t'u jetë e qartë se klubi përpiqet për një kulturë pozitive në të cilën të gjithë mund të jenë vetvetja.

FILLESTAR



VEPRIMI 1

Krijoni kode sjelljeje për të gjithë pjesëmarrësit në klubin tuaj sportiv

Këtu përfshihen rregulla të qarta për: trajnerët, sportistët, stafin, prindërit, anëtarët e bordit – të gjithë që janë të përfshirë në aktivitetet e klubit.

I MODERUAR

VEPRIMI 2



Shpërndani dhe promovoni kodet e sjelljes

Kodet e sjelljes nuk mbeten vetëm në letër. Ato përmenden rregullisht dhe u kujtohen të gjithëve. Pritet që çdo pjesëmarrës në klub t'i respektojë ato

I PERPARUAR

VEPRIMI 3



Sigurohuni që stafi t'i nënshkruajë dhe zbatojë kodet e sjelljes

Personat që punojnë drejtpërdrejt me sportistët – trajnerët, menaxherët dhe stafi teknik – nënshkruajnë kodin e sjelljes dhe shprehin përkushtimin e tyre për të vepruar me etikë dhe përgjegjësi në çdo rast.

PRAKTIKË E MIRË

Kod sjelljeje për trajnerët dhe sportistët në sportet e kontaktit në Flandër (Belgjikë)

Ketu mund ta gjeni perktimin e kodit të sjelljes në Anglisht:


1. Trego respekt dhe ndershmëri në lojë me gjithsecilin.
2. Inkurajoni sjelljen shembullore.
3. Respektoni rregulloret.
4. Mbron sigurinë dhe integritetin e çdo sportisti.
5. Respektoni kufijtë dhe raportoni sjellje të papërshtatshme.
6. Kushtoni vëmendje mirëqenies mendore të sportistëve.
7. Raportoni problemet shëndetësore tek një profesionist.
8. Merrni parasysh zhvillimin individual dhe procesin e të nxënës.
9. Përdorni me përgjegjësi pajisjet sportive dhe ambientet.
10. Kënaqësia në sport duhet gjithmonë të vijë para performancës.



ETHISCH GEDRAG IN ONZE CLUB voor trainers en sporters

1 Toon respect en fairplay naar iedereen.
2 Moedig voorbeeldgedrag aan.
3 Respecteer reglementen.
4 Bescherm de veiligheid en integriteit van elke sporter.
5 Respecteer grenzen & meld grensoverschrijdend gedrag.
6 Heb aandacht voor mentaal welzijn van sporters.
7 Meld gezondheidsproblemen aan een professional.
8 Hou rekening met het individuele ontwikkelings- & leerproces.
9 Gebruik faciliteiten en sportmateriaal verantwoordelijk.
10 Sportplezier staat altijd boven prestatie.

KICKBOKS MUAYTHAI
vecht sport
SPORT. VLAANDEREN



Punësimi i sigurt i stafit
dhe vullnetarëve



Të dish se kë po punëson në klubin tënd sportiv ofron një garanci shtesë për përfshirjen e personave të ndershëm, që kanë në zemër interesin më të mirë të sportistëve të klubit. Identifikimi i roleve të ndryshme dhe profileve të nevojshme është një hap i rëndësishëm fillestar. Një kontroll i thjeshtë i te kaluarës për një trajner apo mbikëqyrës të ri është thelbësor për të garantuar sigurinë e pjesëmarrësve. Për të qenë të sigurt se nuk po punësoni dikë me të kaluar kriminale, mund të kërkonit dhe kontrolloni këtë – kjo varet nga legjislacioni në vendin tuaj.



Merrni në konsideratë profilet që dëshironi të integroni në klubin tuaj duke krijuar një politikë të fortë rekrutimi.

FILLESTAR



VEPRIMI 1

Përcaktoni profilin e punës dhe procedurat e rekrutimit për stafin dhe vullnetarët

Hartoni rolet dhe profilet që ju nevojiten në klub. Kjo do të sigurojë që personi i duhur është në vendin e duhur

I MODERUAR



VEPRIMI 2

Përfshini kontrollin e prapavijës në metodën e rekrutimit

Bëni një kontroll për të kaluarën, për individët që aplikojnë për role trajnimi apo menaxhimi të të rinjve.



I PERPARUAR



VEPRIMI 3

Kontrolloni të kaluarën kriminale

Nëse legjislacioni e lejon, kontrolloni nëse individët kanë të kaluar kriminale para se t'i punësoni.



PRAKTIKË E MIRË

Çfarë duhet të përfshijë procesi i punësimit?

(Nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Sport – MB)

1. Shkruani një përshkrim të qartë të punës

Përshkrimi duhet të përfshijë detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse.

2. Përcaktoni profilin e personit

Përshkruani aftësitë, vlerat dhe përvojën e kërkuar, si:


- ✓ Përvojë me fëmijët
- ✓ Qasje të orientuar te fëmija
- ✓ Kualifikimet sportive ose të tjera

3. Reklamoni rolin e punës

Për të siguruar transparencë dhe pjesëmarrje të gjerë. Reklamoni ose promovoni rolin për të tërhequr reagimin më të gjerë dhe për të demonstruar një proces të hapur rekrutimi. Kjo mund të bëhet përmes buletineve të klubit, faqes së internetit, tabelave të njoftimeve (duke përfshirë edhe ato online), gazetave lokale dhe faqeve të internetit të punës.

H A P I 8

Bashkëpunimet dhe Burimet



Nëse doni të punoni për sport të sigurt brenda klubit tuaj sportiv mos u përpiq të ndërtosh një sport të sigurt vetëm. A është klubi juaj i lidhur me ndonjë shoqatë sportive? A kanë udhëzime në lidhje me zhvillimin e një politike për mbrojtjen? A njihni klube të tjera sportive në zonë me të cilat mund të bashkëpunoni? Dhe nëse përballeni me dhunë ndërpersonale në klub, cilëve partnerë mund t'u drejtoheni? Kërkoni partneritetet e duhura dhe përcaktoni kriteret mbi bazën e të cilave hyni në këto partneritete. Në këtë mënyrë, do të zhvilloni një bazë të fortë për t'ju ndihmuar.



Krijoni partneritete dhe përdorni burime për të ndërtuar një ambient të sigurt sportiv

I MODERUAR



VEPRIMI 1

Vendosni marrëveshje partneriteti për çështjet e sigurisë

Nuk je vetëm! Shumë organizata të tjera sportive e kanë bërë këtë punë para teje, guxo t'u kërkoj ndihmë.



I PERPARUAR



VEPRIMI 2

Konsideroni parimet e sigurisë gjatë vendosjes së partneriteteve

Mos hyni thjesht në çfarëdo partneriteti, guxoni të pyetni veten se cilat norma dhe vlera mendoni se janë të rëndësishme në bashkëpunimet e reja.



H A P I 9



Monitorimi, Vlerësimi dhe Nxënia



Pas përpilimit të plotë të politikave për sigurinë, ato duhet të vlerësohen rregullisht. A funksionojnë procedurat? A ka komente nga anëtarët? Duke e vënë në praktikë politikën, padyshim që do të hasni një numër pengesash. Duke u përqendruar në monitorimin dhe përmirësimin e politikës suaj, do të garantoni që të gjithë brenda klubit tuaj sportiv të mund të performojnë në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.



Vazhdoni të vini në dyshim politikat dhe udhëzimet tuaja. Kërkimi i reagimeve nga anëtarët tuaj është thelbësor.



I PERPARUAR



VEPRIMI 1

Monitoroni dhe vlerësoni politikat dhe procedurat e klubit.

Duke kërkuar rregullisht komente dhe përmirësuar procedurat, siguroheni për një ambient të shëndetshëm dhe të sigurt



✦ **SPORT I SIGURT**

Nje ambjent sportiv i sigurt dhe suportues psikologjikisht dhe fizikisht ku pjesemarrësit mund të marrin dhe perjetojnë te plota perfitimet e sportit.

✦ **MBROJTJA**

Masa parandaluese për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme shqetësimeve që lidhen me ngacmimin dhe abuzimin në sport, si dhe për të promovuar qasje holistike ndaj mirëqenies së atletëve

✦ **DHUNA NDERPERSONALE**

Përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i fuqisë, i kërcënuar ose i vërtetë, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi ose komuniteti, që rezultojnë ose ka një gjasë të lartë të rezultojë në lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim. Dhuna ndërpersonale përfshin përdorimin e qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë kundër personave të tjerë nga një individ ose një grup i vogël individësh. Mund të ndodhë në internet, të kryhet nga aktorë të ndryshëm dhe të marrë forma të ndryshme.

✦ **ABUZIMI NDAJ FËMIJËVE**

Abuzimi ose keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimit seksual, neglizhencës ose trajtimit neglizhent ose shfrytëzimit komercial ose të çdo lloji tjetër, që rezultojnë në dëmtim real ose potencial të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit të fëmijës në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti.

✦ **DHUNA SEKSUALE
(PËRFSHIN NGACMIMET SEKSUALE)**

Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose ngacmime seksuale të padëshiruara, ose akte për trafikim, ose të drejtuara ndryshe kundër seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga çdo person pavarësisht nga marrëdhënia e tij me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Këto forma të ndryshme të dhunës seksuale mund të ndodhin si në internet ashtu edhe personalisht

✦ **DHUNA FIZIKE**

Dhuna fizike është një akt që përpiket të shkaktojë ose rezultojnë në dhimbje dhe/ose lëndime fizike. Dhuna fizike përfshin rrahjen, djegien, shqelmin, grushtimin, kafshimin, gjymtimin ose vrasjen, ose përdorimin e objekteve ose armëve.

✦ **DHUNA PSIKOLOGJIKE**

Dhuna psikologjike (abuzimi) përfshin përdorimin e rregullt dhe të qëllimshëm të një sërë fjalësh dhe veprimesh jofizike të përdorura me qëllim manipulimin, lëndimin, dobësimin ose frikësimin e një personi mendërisht dhe emocionalisht; dhe/ose shtrembërimin, ngatërrimin ose ndikimin e mendimeve dhe veprimeve të një personi brenda jetës së tij të përditshme, duke ndryshuar ndjenjën e tij për veten dhe duke dëmtuar mirëqenien e tij. Në sport, ajo mund të marrë gjithashtu formën e veprimeve jofizike që mund të shkaktojnë dëm fizik ose psikologjik tek atleti. Dhuna psikologjike mund të ndodhë në internet dhe jashtë tij në forma të ndryshme.

✦ **NEGLIZHENCA**

Neglizhenca përfshin dështimin për të siguruar standard të përshtatshëm të ushqyerjes, kujdesit mjekësor, veshjes, strehimit ose mbikëqyrjes deri në masën që shëndeti ose zhvillimi i atletit dëmtohet ndjeshëm ose vihet në rrezik serioz. Një atlet neglizhohet nëse lihet pa kujdes për periudha të gjata kohore ose braktiset.

✳ ZYRTARI I MBROJTJES

Person që kontribuon në parandalimin e incidenteve të dhunës ndërpersonale dhe në reagimin ndaj shqetësimeve, duke mbrojtur individët, veçanërisht fëmijët dhe personat vulnerabël, brenda një mjedisi sportiv.

✳ POLITIKA E MBROJTJES

Dokument që përshkruan angazhimin, parimet dhe qasjen e një organizate sportive për të mbrojtur individët nga dhuna ndërpersonale në sport.

✳ PROCEDURAT E MBROJTJES

Hapa ose veprime specifike që ndjek një organizatë sportive, për të vënë në vend dhe për të arritur objektivat e një politike mbrojtëse, duke mbrojtur individët nga dhuna ndërpersonale në sport.

✳ SHQETËSIM PËR MBROJTJEN

Situatë që ndikon në sigurinë dhe mirëqenien e individëve brenda një mjedisi sportiv, që shkakton dëm ose i vë ata në rrezik dëmtimi.

✳ PROCEDURAT E RAPORTIMIT / REAGIMIT / NDJEKJES

Procesi ose sistemet formale që një organizatë sportive ka në vend për t'u lejuar individëve të raportojnë shqetësime.

✳ PROCEDURA DHE MEKANIZMI I REAGIMIT

Procesi ose sistemet formale që një organizatë sportive ka në vend për të trajtuar dhe menaxhuar një shqetësim të raportuar në kohë dhe në mënyrë efektive.

✳ PROTOKOLI I NDJEKJES

Hapat specifikë që ndjek një organizatë sportive për të siguruar që një shqetësim i raportuar të trajtohet në mënyrë të përshtatshme dhe individët e përfshirë të mbrohen

✳ STANDARDET MINIMALE TË OPERIMIT

Një sërë masash proaktive të rekomanduara për aktivitetet e përditshme të një organizate sportive, standarde të hartuara për të parandaluar incidentet e dhunës ndërpersonale.

✳ KODI I SJELLJES

Një sërë rregullash, parimesh dhe udhëzimesh që përshkruajnë sjelljet, praktikat dhe standardet etike të pritura për individët, duke i udhëzuar njerëzit se si të veprojnë në situata të ndryshme brenda një mjedisi sportiv.

✳ PUNËSIMI I SIGURT

Procesi i përzgjedhjes së individëve për role brenda një organizate sportive (p.sh., trajnerë, staf, vullnetarë) që siguron sigurinë dhe mirëqenien e individëve. Qëllimi është të parandalohet qasja e personave që mund të përbëjnë rrezik për të tjerët, nga punësimi ose përfshirja në organizatë.



Ky Paketë Mjetesh Dixhitale për Sport të Sigurt u zhvillua për të mbështetur klubet në krijimin e mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe respektuese. Është rezultat i një përpjekjeje bashkëpunuese midis ekspertëve dhe organizatave të përkushtuara për mbrojtjen në sport.

Autori: Sportieq, Evy Van Coppenolle

Partnere e Projekti GRASS:

NOC Portugal (Cristina Almeida ose Joana Gonçalves)

Universiteti VIC (Montserrat Martin)

Qantara Sports (Bruno Rosa, Bruno Bidarra ose Miguel Nery)

NOC Slovenia (Peter Dokl)

NOC Albania (Alda Imeraj)

Ministria e Rinisë dhe Sportit të Bullgarisë (Iliana Hristova)

Projektuar dhe proshuar: Trien Pauwels, www.trien.org

Fotografia: Pexels, Shutterstock, Unsplash

Data e Publikimit: Tetor 2025

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:

safegrassport@comiteolimpicoportugal.pt ose visit www.safegrasssport.eu






SAFER
GRASSROOTS
SPORT



Co-funded by
the European Union